



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. Nr. 744/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga, Agon Ramadani Kryetar, Vedat Poterqoi, Anëtar dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik, (OE) "Rsm Company" sh.p.k, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale" me numër të prokurimit: 616-22-11453-2-1-1, iniciuar nga AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datën 08.02.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

I. Aprovohet, si e bazuar, ankesa e operatorit ekonomik, "Rsm Company" sh.p.k me seli në Prishtinë, nr.744/22, përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale" me numër të prokurimit: 616-22-11453-2-1-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

II. Obligohet, Autoritetit Kontraktues, Komuna e Prishtinës, që ta bëjë korigjimet në njoftimin për Kontratë sipas ekspertizës si dhe gjithashtu të zgjatet afati i dorëzimit të ofertave në Njoftimi për kontratë i publikuar në e-prokurim me datë 19.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale" me numër të prokurimit: 616-22-11453-2-1-1.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për

mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

IV. Me qenë se ankesa e Operatorit Ekonomik, “Rsm Company” sh.p.k me seli në Prishtinë, aprovohet, si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar mel rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

V. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

### **A r s y e t i m**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 30.11.2022,ka pranuar ankesë nga “Rsm Company” sh.p.k me seli në Prishtinë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me numër të prokurimit: 616-22-11453-2-1-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 744/2022.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar Kontratën Publike Kornizë – shërbim, procedurë e hapur vlera e parashikuar e kontratës:160,000.00 €.

Për aktivitetin prokurimit në fjalë Autoriteti Kontraktues me datën 19.10.2022,ka publikuar Njoftim për Kontratë. Afati i fundit për e dorëzimit të ofertave është data 06.12.2022 ora 13.30.

Po ashtu me AK lidhur me këtë aktiviteti të prokurimit me datë 25.10.2022; datë 24.11.2022; të datës 01.12.2022 ka publikuar e-prokurim Njoftim për Informata shtesë ose Permiresim i Gabimit.

Me datë 17.11.2022,OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 24.11.2022,AK Komuna e Prishtinës refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik “Rsm Company” sh.p.k për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me numër të prokurimit: 616-22-11453-2-1-1.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç’rast OE është pajtuar pjeserisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa bazuar në shkresat e lëndës në dispozicion, AK nuk ka kthyer përgjigje lidhur me mendimin ekspertit shqyrtues.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 18.12.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “Rsm Company” sh.p.k me seli në Prishtinë të aprovohet pjesërisht si e bazuar,

- AK të bëjë korrigjimet sipas ekspertizës dhe gjithashtu të zgjatet afati i dorëzimit të ofertave, pajtim me dispozitat e LPP-së.

***-Seanca dëgjimore***

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

***-Konstatimet e ekspertit shqyrtues***

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Rsm Company” sh.p.k me seli në Prishtinë.

Përgjigjeje në pretendim Nr.1

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga operatori ekonomik “Rsm Company sh.p.k”. Prishtinë duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, për këtë aktiviteti të prokurimit sqaron se AK-ja në Njoftimin për kontratë, tek Njoftim për Informata Shtesë ose Permiresim i Gabimit të publikuara me datë .25.10.2022; datë 24.11.2022; të datës 01.12.2022 tek Kapaciteti teknik dhe profesional si dhe në dosje të tenderit në Aneksin 7. Lista e Autoriteteve Kontraktuese - Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve për sinjalizim horizontal të trafikut rrugor është kërkuar Makina special për sinjalizim horizontal ku specifika e kërkuar nene piken b. Makina duhet të ketë mekanizmin për realizimin e vijave me ngjyrë term plastik dhe sprej, sqaron se ky kriter e ngushton zgjidhjen e kërkuar sepse ekzistojë makina me specifika tjera të cilat mund të kryejnë punën e njëjtë, pra kërkesa nene piken b. Që Makina duhet të ketë mekanizmin për realizimin e vijave me ngjyrë term plastik dhe sprej rekomandoj që të jetë b. Makina duhet të ketë mekanizmin për realizimin e vijave me ngjyrë term plastik , sprej dhe paste.Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se kjo kërkesë- pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Përgjigjeje në pretendim Nr.2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga operatori ekonomik “Rsm Company sh.p.k”. Prishtinë duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara

në platformën elektronike e-prokurim, për këtë aktiviteti të prokurimit sqaron se AK-ja në Njoftimin për kontratë, tek Njoftim për Informata Shtesë ose Permiresim i Gabimit të publikuara me datë .25.10.2022; datë 24.11.2022; të datës 01.12.2022 tek Kapaciteti teknik dhe profesional si dhe në dosje të tenderit në Aneksin 7. Lista e Autoriteteve Kontraktuese - Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve për sinjalizim horizontal të trafikut rrugor është kërkuar Makina special për sinjalizim horizontal ku specifika e kërkuar nene piken c. Kapaciteti i ngjyrës 400 kg;

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja me Vendimin për rishqyrtim të ankese se OE ankues të datës 24.11.2022 për këtë pretendim jepe këtë arsyetim se “sa i përket kapacitetit është parapare të jetë 400 kg apo me i madhe d.m.th. mund të jetë dhe me shume se 400 kg , sepse sa me i madhe kapaciteti i ngjyrës realizimi i punimeve në teren është me i shpejtë, me i mire dhe me efikas dhe e kundërta”Eksperti shqyrtues mendon se ky arsyetim është i mjaftueshëm dhe nuk e kufizon pjesëmarrjen sepse kërkohet që kapaciteti të jetë 400 kg apo me i madhe, pra nuk e kufizon kapacitetin e ngjyrës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se kjo kërkesë-pretendim i OE ankues është i pa bazuar

### Përgjigjeje në pretendim Nr.3

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga operatori ekonomik “Rsm Company”sh.p.k. Prishtinë duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, për këtë aktiviteti të prokurimit sqaron se AK-ja në Njoftimin për kontratë, tek Njoftim për Informata shtesë ose Permiresim i Gabimit të publikuara me datë .25.10.2022; datë 24.11.2022; të datës 01.12.2022 tek Kapaciteti teknik dhe profesional si dhe në dosje të tenderit në Aneksin 7. Lista e Autoriteteve Kontraktuese - Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve për sinjalizim horizontal të trafikut rrugor është kërkuar Makina special për sinjalizim horizontal ku specifika e kërkuar nene piken b. Kapaciteti i ngjyrës  $\geq 200$  kg;

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja në Njoftimin për kontratë, tek Njoftim për Informata Shtese ose Permiresim i Gabimit te publikuara me datë 25.10.2022; datë 24.11.2022; të datës 01.12.2022 tek Kapaciteti teknik dhe profesional si dhe në dosje të tenderit në Aneksin 7. Lista e Autoriteteve Kontraktuese - Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve për sinjalizim horizontal të trafikut rrugor ka kërkuar Makina special për sinjalizim horizontal ku specifika e kërkuar nene piken b. Kapaciteti i ngjyrës kanë parapare që kapaciteti i ngjyrës të jetë 200 kg apo më i madhe se 200 kg nuk është diskriminues sepse ; sepse sa me i madhe kapaciteti i ngjyrës të jetë realizimi i punimeve në teren është me i shpejtë, me i mirë dhe me efikas dhe e kundërta”.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se kjo kërkesë-pretendim i OE ankues është i pa bazuar

### **MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankuesit “Rsm Company sh.p.k”. Prishtinë, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, rekomandohet AK që të bëjë korrigjimet sipas ekspertizës dhe gjithashtu të zgjatet afati i dorëzimit të ofertave.

### *-Konstatimet e Panelit Shqyrtues*

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron:

Gjatë përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes, PSH merr në konsideratë qëllimin AK-ve që kontrata specifike kërkojnë kompani profesionale si shkak i natyrës së tyre si dhe për faktin e punëve specifike konform vlerës së parashikuar, por PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim.

Andaj, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues se Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kritere diskriminuese, PSH mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është se një nga tri pretendimet e paraqitura si subjekt i kësaj ankese në relacion me kërkesat në DT, si të tilla mund të paraqesin diskriminim, andaj PSH përmes këtij vendimi obligon AK që të bëhen përmirësimet konform vlerësimit të ekspertit shqyrtues, të bëra në raportin e ekspertizës së tij. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues, në të gjitha pretendimet ankimore.

Paneli shqyrtues në relacion me pretendimet ankimore të paraqitura në këtë ankesë konstaton se lidhur me pretendimin e parë ankimor të parashtruar nga OE "Rsm Company sh.p.k", se kërkesa në DT ku lloji i mekanizimit dhe pajisjeve për sinjalizim horizontal të trafikut rrugor është kërkuar Makina special për sinjalizim horizontal ku specifika e kërkuar nënën piken b. Makina duhet të ketë mekanizmin për realizimin e vijave me ngjyrë term plastik dhe sprej, PSH konform mendimit të ekspertit këtë pretendim e klasifikon si të bazuar duke marrë parasysh faktet dhe argumentet e parashtruara nga palët, PSH konsideron se ky kriter mund ta ngushtojë konkurrencën për faktin se sqarimet e dhëna në këtë ankesë tregojnë që ekzistojnë makineri me specifika tjera të cilat mund të kryejnë punën e njëjtë, duke mos cënuar qëllimin, kualitetin dhe efikasitetin e punëve, pra kërkesa nënën piken b. që makina duhet të ketë mekanizmin për realizimin e vijave me ngjyrë term plastik dhe sprej, për të cilën eksperti rekomandon që të jetë b. Makina duhet të ketë mekanizmin për realizimin e vijave me ngjyrë term plastik, sprej dhe pastë. Andaj bazuar në



dëshmitë, faktet dhe argumentet e paraqitura nga palët në procedurë, PSH konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me dy pretendimet tjera të OE ankues që kërkesat lidhur me makinën e lartpërmendur si dhe makinën për vijë akrylike, për të cilat pretendon se kapaciteti i kërkuar (së paku 400kg dhe së paku 200kg) janë kritere diskriminuese dhe favorizuese dhe lidhur me këto kritere rekomandon që të largohen në tërësi, PSH këto pretendime i klasifikon si të pabazuara për faktin se në këtë rast OE ankues nuk ka ofruar dëshmi, fakte argumente që vërtetojnë se këto kërkesa janë diskriminuese dhe favorizuese, apo si të tilla nuk cenojnë kualitetin dhe efikasitetin e punëve që do të realizohen, për më tepër, në ankesën e paraqitur, PSH vlerëson se OE ankues në këtë rast nuk ka paraqitur zgjidhje alternative lidhur me përpilimin e këtyre kritereve duke kërkuar që të njëjtat të hiqen në tërësi, andaj PSH deri tek vendimmarrja lidhur me këto pretendime ka gjetur mbështetje në arsyeshmerinë e AK-së si dhe ekspertit shqyrtues me të cilat sqarohet se kapaciteti minimal i kërkuar përveç të tjerash mundëson edhe realizimin e punimeve në terren në mënyrë më të shpejtë dhe më efikas, si dhe si kritere të tilla nuk kufizojnë kapacitetin e ngjyrës së referuar, kështu që rrjedhimisht këto pretendime, PSH i klasifikon si të pabazuara.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Prishtinës.

1x1 OE "Rsm Company" sh.p.k, me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.